



Nr. 194/12 Prot.  
Datë, më 09.10.2023

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
MINISTRI

Nr. 19109 prot.

Data: 6.10.2023

VENDIM

Nr. 74, Datë 6.10.2023

PËR

VLERËSIMIN NË KUADËR TË HEQJES SË AKREDITIMIT ME KUSHT PËR  
OFRUESIN PUBLIK TË AFP-SË SHKOLLËN E MESME PROFESIONALE  
“BEQIR ÇELA” DURRËS

Bazuar në pikën 2, të nenit 25, të ligjit nr. 15/2017, datë 16.2.2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, dhe urdhrin nr. 128, datë 06.07.2021, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Për miratimin e Rregullores për Standardet, Kriteret dhe Procedurat e Akreditimit të Ofruesve të Arsimit dhe Formimit Profesional”;

VENDOSI:

1. Ofruesi publik i AFP-së Shkolla e mesme Profesionale “Beqir Çela” Durrës, i ka plotësuar kushtet e vendosura në Vendimin nr. 8 datë 17.02.2023, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, **Akreditim me kusht** me afat vlefshmërie deri më 16.08.2023.
2. Bazuar në Raportin e Monitorimit të Posaçëm dhe Urdhrin të miratimit të tij, i jepet vlerësimi përfundimtar pozitiv **akreditim i plotë** dhe heqja e kushteve të akreditimit sipas vendimit nr. 8, datë 17.02.2023, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë për kualifikimet profesionale si më poshtë:

- |                                 |                               |
|---------------------------------|-------------------------------|
| 1. “Shërbim mjeteve transporti” | Niveli II në KSHK, M-II-17    |
| 2. “Shërbime motorike”          | Niveli III në KSHK, M1-III-18 |
| 3. “Shërbime xhenerike”         | Niveli III në KSHK, M2-III-18 |
| 4. “Shërbime elektroauto”       | Niveli III në KSHK, M3-III-18 |
| 5. “Shërbim mjeteve transporti” | Niveli IV në KSHK, M-IV-15    |
| 6. “Mekanike”                   | Niveli II në KSHK, F-II-17    |

- |  |                               |
|--|-------------------------------|
| 7. “Elektroteknikë”                          | Niveli II në KSHK, E-II-17    |
| 8. “Instalim elektrik civil dhe industrial”  | Niveli III në KSHK, E1-III-18 |
| 9. “Riparime të pajisjeve elektroshtëpiake”  | Niveli III në KSHK, E2-III-19 |
| 10. “Elektromekanikë”                        | Niveli III në KSHK, E4-III-19 |
| 11. “Elektroteknikë”                         | Niveli IV në KSHK, E-IV-21    |
| 12. “Teknologji informacioni dhe komunikimi” | Niveli II në KSHK, T-II-19    |
| 13. “Mbështetje e përdoruesve të TIK”        | Niveli IV në KSHK, T2-IV-21   |
| 14. “Zhvillim website”                       | Niveli IV në KSHK, T3-IV-21   |

3. Afati përfundimtar i **akreditimit të plotë** është 4 vite, duke filluar nga data e firmosjes së këtij vendimi.

4. Bazuar në pikën 1; shkronja a) e nenit 18, të Urdhrit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.128 datë 6.7.2021 për miratimin e “Rregullores për Standardet, Kriteret dhe Procedurat e Akreditimit të Ofruesve të Arsimit dhe Formimit Profesional”, ofruesi publik i AFP-së Shkolla e mesme Profesionale “Beqir Çela”, Durrës, do t’i nënshtrohet vlerësimit të jashtëm çdo 4 vjet periodikisht, në kuadër të procesit të akreditimit institucional.

5. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve për zbatimin e këtij vendimi, publikimin dhe lëshimin e certifikatës së akreditimit të plotë, brenda një muaji nga data e marrjes së këtij vendimi, si dhe monitorimin e vazhdueshëm, për të garantuar qëndrueshmërinë e përmirësimeve të reflektuara në kuadër të plotësimit të kriterëve dhe veçanërisht ato që lidhen me zbatimin e rekomandimeve të lëna në raportin përfundimtar të akreditimit.

6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.





237  
27.5.2024

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT  
MINISTRI

Nr. 6572/1 prot.

Data: 21, 5, 2024

VENDIM

Nr. 6572/1, Datë 21, 5, 2024

Bazuar në pikën 2, të nenit 25, të ligjit nr. 15/2017, datë 16.02.2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", dhe urdhrin nr. 128, datë 06.07.2021, të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, në kuadër të vendimmarrjes për akreditimin e ofruesit të AFP-së, me të dhëna si më poshtë:

1. **Emri i ofruesit të AFP-së:** Shkolla e Mesme Profesionale "Beqir Çela", Durrës
2. **Akti zyrtar i themelimit/licencimit:** Urdhër nr. 490, datë 27.12.2005, protokolluar me nr. 8936 prot., i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës "Për dhënien e statusit "shkolla të nivelit kombëtar" disa shkollave të mesme teknike, profesionale dhe social-kulturore".
3. **Organizimi i institucionit:** Shkollë mesme profesionale publike
4. **Lloji i ofruesit të AFP-së:** Shkollë mesme profesionale
5. **Nipti:** K51703523G

Pasi mora në shqyrtim dokumentacionin e vetëvlerësimit, raportin e vetëvlerësimit, dokumentacionin e vlerësimit të jashtëm, raportin e vlerësimit të jashtëm për akreditim, si dhe të gjithë procedurën e akreditimit të zbatuar nga Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAFPK),

**konstatoj se:**

- a. procedura dhe procesi i vlerësimit të jashtëm për akreditim janë kryer në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore dhe afatet e përcaktuara nga AKAFPK-ja për këtë proces;
- b. vlerësimi në përmbajtje është i mbështetur në dokumentacionin e vetëvlerësimit, vlerësimin e jashtëm dhe gjetjet e verifikimit gjatë vizitës në terren;
- c. raporti është hartuar në përputhje me kërkesat dhe i mbështetur me fakte, të dhëna e dokumentacion plotësues.

*Mbështetur mbi rezultatet dhe arsyetimin e mësipërm,*

**VENDOS:**

1. Akreditimin e plotë për kualifikimet profesionale:

- a) "Termohidraulikë" Niveli II në KSHK, Kodi V-II-20
- b) "Instalime hidraulike" Niveli III në KSHK, Kodi V1-III-22
- c) "Instalime të sistemeve ngrohëse – ftohëse" Niveli III në KSHK, Kodi V2-III-22
- d) "Termohidraulikë" Niveli IV në KSHK, Kodi V-IV-23

Në përputhje me propozimin përkatës nr. 177/9, datë 08.11.2023 ardhur nga AKAFPK-ja (bashkëlidhur këtij urdhri):

2. Ofruesi i AFP-së t'i nënshtrohet vlerësimit dhe akreditimit periodik institucional sipas kësaj rregulloreje, çdo 4 vjet.

Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve për zbatimin e këtij vendim, publikimin dhe lëshimin e certifikatës së akreditimit brenda një muaji nga data e marrjes së këtij vendimi, si dhe monitorimin e rekomandimeve sipas shtojcës bashkëlidhur.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT  
AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT, FORMIMIT PROFESIONAL DHE KUALIFIKIMEVE

Nr. 245/2 Prot.

Tiranë, më 17, 6 2026

URDHËR

Nr. 37, datë 17-6 2026

PËR

MIRATIMIN E RAPORTIT TË MONITORIMIT DHE RIFRESKIMIN E  
CERTIFIKATËS SË AKREDITIMIT ME KUALIFIKIME TË REJA TË PLOTA PËR  
SHKOLLËN E MESME PROFESIONALE “BEQIR ÇELA”, DURRËS

Bazuar në ligjin nr. 10 247, datë 4.3.2010, “Për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve” i ndryshuar; në ligjin nr. 69/2012 “Për Sistemin Arsimit Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në pikën 2 të nenit 25, të ligjit nr. 15/2017, datë 16.02.2017, “Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; në Urdhrin nr. 156, datë 04.03.2026 për disa shtesa dhe ndryshime në urdhrin nr. 99, datë 25.5.2021, “Për miratimin e Katalogut Kombëtar të Kualifikimeve Profesionale” i ndryshuar, si dhe në zbatim të urdhrin të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit nr. 845 datë 3.7.2025 për miratimin e “Rregullores për Standardet, Kriteret dhe Procedurat e Akreditimit të Ofruesve të Arsimit dhe Formimit Profesional”, neni 8, pika 1, 6 dhe 7, neni 25, pika 1, 2 dhe pika 3 gërma a), neni 26 pika 1 dhe 2, gërma d), dhe neni 27 pika 6”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e Raportit të Monitorimit për Shkollën e Mesme Profesionale “Beqir Çela”, Durrës.
2. Rifreskimin e të dhënave të certifikatës së akreditimit për të pasqyruar shtimin e kualifikimeve profesionale si më poshtë:
  - “Diagnostikim-menaxhim në autoservis”, Niveli V në KSHK, M1-V-23
  - “Energji e rinovueshme”, Niveli V në KSHK, E1-V-24
  - “Shërbime elektro-auto” (Arsim i dyfishtë), Niveli III në KSHK, M3-III-22

3. Certifikatat e mëparshme të akreditimit të revokohen dhe të zëvendësohet me certifikatën e rifreskuar.
4. Certifikata e akreditimit e rifreskuar hyn në fuqi në datën e lëshimit dhe ka të njëjtin afat vlefshmërie me certifikatën e mëparshme të akreditimit, sipas vendimit të fundit të MEKI nr. 6572/1 datë 21.05.2024.
5. Ngarkohet Sektori i Akreditimit të Ofruesve të AFP-së për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**Ejvis GISHTI**

